



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0543

Paneli Shqyrtues, duke vendosur në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar,, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) lidhur me ankesën e OE N.P.T. "Haxhijaha" SH.P.K., ushtruar kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim I fermerve me mekanizem bujqesor" me numër të prokurimit:616-26-4982-1-1-1, iniciuar nga Komuna Prishtine në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), më 03/09/2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OEN.P.T. "Haxhijaha" SH.P.K., me nr. 2026/0543 e datës 27/07/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim I fermerve me mekanizem bujqesor" me numër të prokurimit:616-26-4982-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktuesKomuna Prishtine (AK), ndërsa AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna Prishtine në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim I fermerve me mekanizem bujqesor" me

numër të prokurimit: 616-26-4982-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 290,000.00 €.

Me 15.07.2026, OEN.P.T. "Haxhijaha" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Kërkesa i është refuzuar si e pa bazuar nga Autoriteti Kontraktues.

Me 27.07.2026, OSHP ka pranuar ankesën nga OEN.P.T. "Haxhijaha" SH.P.K., me nr. 2026/0543 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim I fermëve me mekanizëm bujqësor" me numër të prokurimit: 616-26-4982-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.P.T. "Haxhijaha" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Në arsyetim të pretendimeve ankimore lidhur me shkeljen e dispozitave ligjore të sipërcekura, Operatori Ekonomik, në deklaratën e detajuar mbi faktet dhe argumentet, ka theksuar si vijon:

Në kërkesën tonë për rishqyrtim, të paraqitur pranë Autoritetit Kontraktues, kemi identifikuar dhe argumentuar me fakte konkrete shkeljet që, sipas vlerësimit tonë, bien ndesh me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës (LPPK). Për secilin pretendim kemi paraqitur argumente dhe referenca konkrete, duke dëshmuar se kërkesat e kontestuara në dosjen e tenderit nuk janë në përputhje me parimet dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, është kufizuar vetëm në konstatimin se kërkesa jonë është e papabazuar, duke pretenduar njëkohësisht se ne nuk kemi ofruar prova apo fakte mbështetëse. Një konstatim i tillë nuk qëndron, pasi në kërkesën tonë janë paraqitur argumente të qarta faktike dhe juridike, të cilat nuk janë trajtuar, analizuar apo kundërshtuar në mënyrë konkrete nga Autoriteti Kontraktues.

Për më tepër, në fund të përgjigjes së tij, Zyrtari i Prokurimit deklaroi se i ka dhënë besim të plotë sqarimeve të ofruara nga Njësia Kërkuese. Është e vërtetë se Njësia Kërkuese, në përputhje me kompetencat e saj, është përgjegjëse për përgatitjen e detyrës projektuese, projektit dhe specifikimeve teknike të aktivitetit të prokurimit. Mirëpo, përcaktimi i kriterëve të kualifikimit dhe kërkesave që operatorët ekonomikë duhet ti plotësojnë gjatë pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit është kompetencë dhe përgjegjësi ekskluzive e Zyrtarit të Prokurimit dhe e Autoritetit Kontraktues, në përputhje me dispozitat e LPPK-së. Për rrjedhojë, çdo përpjekje për ta arsyetuar vendosjen e këtyre kërkesave duke iu referuar përgjegjësi të Njësies Kërkuese është juridikisht

e paqëndrueshme dhe nuk e liron Autoritetin Kontraktues nga përgjegjësia për hartimin e ligjshëm të Dosjes së Tenderit.

Ankesa jonë nuk ka të bëjë me projektin, detyrën projektuese apo specifikimet teknike të hartuara nga Njësia Kërkuese. Objekt i ankesës sonë janë ekskluzivisht kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në Formularin e Dosjes së Tenderit (FTD), të cilat operatorët ekonomikë duhet ti përmbushin për të marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit. Pikërisht për këto kërkesa kemi kërkuar rishqyrtim, duke argumentuar se ato janë në kundërshtim me dispozitat e LPPK-së dhe cenojnë parimet e konkurrencës së lirë, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Për rrjedhojë, nuk pajtohem me konstatimin e Autoritetit Kontraktues se kërkesa jonë për rishqyrtim është e pabazuar. Konsiderojmë se përgjigjja e dhënë nuk përmban analizë të pretendimeve tona, nuk adreson argumentet dhe faktet e paraqitura dhe nuk ofron arsyetim të mjaftueshëm ligjor për refuzimin e kërkesës sonë, duke e bërë vendimin e Autoritetit Kontraktues të pambështetur në fakte dhe në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

PRETENDIMI 1:

Pas shqyrtimit të dosjes së tenderit, konkretisht Fletës së të Dhënave të Tenderit, te kërkesat me numër 9.1 dhe 9.2, që kanë të bëjnë me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kemi konstatuar se kërkesa nr. 1 nuk është në përputhje me natyrën dhe objektin e kësaj kontrate.

Në kërkesën nr. 1 është përcaktuar, citojmë:

"OE duhet të ketë një agronom të diplomuar për dhënien e këshillave për fermerë për përdorimin e pajisjeve bujqësore."

Ndërsa si dëshmi është kërkuar:

"Të dorëzohet diploma e Fakultetit të Bujqësisë dhe kontrata e punës minimumi 1 (një) vit, sa zgjat periudha e monitorimit."

Vlerësojmë se kjo kërkesë nuk lidhet me objektin e prokurimit, pasi kjo procedurë është zhvilluar për furnizim me pajisje/mekanizëm bujqësor dhe jo për ofrim shërbimesh këshilluese.

Vetë formulimi i kriterit dhe dëshmisë kërkon që operatori ekonomik të ofrojë një shërbim këshillimor gjatë periudhës së monitorimit, gjë që nuk është pjesë e objektit të kontratës së furnizimit. Kjo nënkupton se autoriteti kontraktues po kërkon nga operatorët ekonomikë një shërbim profesional, ndërkohë që procedura është shpallur si kontratë furnizimi.

Për më tepër, kërkesa që agronomi të japë këshilla për përdorimin e pajisjeve bujqësore nuk përputhet me profilin profesional të agronomit. Kompetencat profesionale të një agronomi lidhen kryesisht me:

- këshillimin për mbjelljen dhe kultivimin e bimëve;
- analizën e tokës dhe rekomandimin e plehrave;
- identifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve;
- planifikimin e ujitjes dhe praktikave të kultivimit;
- monitorimin e zhvillimit të kulturave bujqësore;
- rekomandimin e metodave moderne të prodhimit bujqësor;

- këshillimin për përzgjedhjen e farave dhe varieteteve të përshtatshme.

Asnjë nga këto kompetenca nuk lidhet drejtpërdrejt me trajnimin ose këshillimin teknik për përdorimin dhe operimin e mekanizmit apo pajisjeve bujqësore, kompetencë e cila zakonisht i përket prodhuesit, distributorit ose personelit teknik të specializuar për pajisjet përkatëse.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se ky kriter është joproporcional, nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës dhe kufizon pa nevojë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke qenë në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe konkurrencës efektive në procedurat e prokurimit publik.

Për këto arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të rishqyrtojë këtë kriter dhe ta largojë atë nga dosja e tenderit, pasi nuk është i lidhur me natyrën dhe objektin e kësaj kontrate të furnizimit.

Pergjigje ne letren e AK-se rreth kerkeses per rishqyrtim:

Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, e ka cilësuar këtë pretendim si të pabazuar, duke arsyetuar se kërkesa për angazhimin e stafit profesional është e domosdoshme për shkak të periudhës së monitorimit të pajisjeve dhe përdorimit të tyre. Sipas Autoritetit Kontraktues, gjatë kësaj periudhe fermerët duhet të kenë një adresë ku mund të kërkojnë këshilla lidhur me përdorimin e pajisjeve bujqësore të furnizuara.

Ky arsyetim është i pabazuar dhe nuk qëndron as në aspektin faktik e as në atë ligjor. Siç kemi theksuar edhe në kërkesën tonë për rishqyrtim, detyrat dhe kompetencat profesionale të një agronomi nuk kanë të bëjnë me ofrimin e udhëzimeve teknike për përdorimin, servisimin apo mirëmbajtjen e pajisjeve bujqësore. Roli i agronomit është të ofrojë ekspertizë në fushën e prodhimit bimor dhe blegtoral, menaxhimit të kulturave bujqësore dhe praktikave agroteknike, e jo të kryejë funksione që lidhen me përdorimin teknik të makinerive dhe pajisjeve bujqësore.

Për më tepër, aktiviteti i prokurimit në fjalë është kontratë furnizimi dhe jo kontratë shërbimi. Si rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë të ofrojnë shërbime këshillimore apo profesionale që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës së furnizimit. Çdo operator ekonomik që ushtron këtë veprimtari disponon staf teknik, si mekanikë ose serviserë, të cilët janë kompetentë për të ofruar

mbështetje teknike, servisimin dhe eliminimin e defekteve të pajisjeve, si gjatë periudhës së garancisë ashtu edhe pas përfundimit të saj.

Në praktikë, çdo nevojë që fermerët mund të kenë lidhur me funksionimin ose përdorimin e pajisjeve bujqësore adresohet drejtpërdrejt tek operatori ekonomik furnizues, përmes shërbimit të servisit dhe mbështetjes teknike. Për këtë arsye, kërkesa për angazhimin e një agronomi nuk ka lidhje logjike dhe funksionale me realizimin e kontratës së furnizimit dhe nuk kontribuon në përmbushjen e objektit të saj.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka nevojë që fermerëve tu ofrohen shërbime këshillimore profesionale në fushën e agronomisë, siç janë këshillat për kultivimin e kulturave bujqësore, mbrojtjen e bimëve apo praktikat agroteknike, atëherë këto shërbime duhet të prokurohen përmes një procedure të veçantë për kontratë shërbimi, në përputhje me natyrën e atyre shërbimeve. Nuk është e ligjshme që kërkesa të tilla të përfshihen në një procedurë prokurimi për furnizim, duke vendosur kritere të panevojshme dhe joproporcionale për operatorët ekonomikë.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë një shqyrtim objektiv të pretendimeve tona, por është mjaftuar me një arsyetim të përgjithshëm që pasqyron nevojat e tij të supozuara, pa dëshmuar lidhjen ndërmjet kërkesës për agronom dhe objektit të kontratës. Një arsyetim i tillë nuk e justifikon vendosjen e këtij kriteri dhe nuk rrëzon argumentet tona se kërkesa është joproporcionale, kufizuese e konkurrencës dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

PRETENDIMI 2:

- Në Dosjen e Tenderit, konkretisht në Fletën e të Dhënave të Tenderit, te kërkesat me numër 9.1 dhe 9.2, që kanë të bëjnë me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, në kërkesën nr. 2 është përcaktuar, citojmë:

"OE duhet që gjatë procesit të aplikimit ta dorëzojë katalogun me informata të mjaftueshme dhe dëshmi që pajisjet me të cilat është duke aplikuar ti kenë specifikat e kërkuara. Të gjitha specifikat duhet të gjenden në katalogun e dorëzuar gjatë aplikimit, pasi të vlerësohen lidhur me cilësinë e pajisjeve që do ti ofrojnë. Cilësia e pajisjeve duhet të jetë e lartë dhe të njohura nga kompanitë prodhuese të pranueshme për cilësi të prodhimit."

Ndërsa si dëshmi është kërkuar:

"Kopja e katalogut me informata të mjaftueshme dhe dëshmi që pajisjet me të cilat është duke aplikuar ti kenë specifikat e kërkuara. Të gjitha specifikat duhet të gjenden në katalog."

Konsiderojmë se kjo kërkesë është e paqartë dhe lë hapësirë për interpretim subjektiv, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar asnjë kriter objektiv mbi bazën e të cilit do të vlerësohet nëse "cilësia e pajisjeve është e lartë" apo nëse prodhuesi është "kompani e pranueshme për cilësi të prodhimit".

Nga formulimi aktual nuk është e qartë se:

- cilat standarde, certifikime apo kriteret do të përdoren për të vlerësuar cilësinë e pajisjeve;
- cilat kompani prodhuese konsiderohen "të pranueshme";
- mbi çfarë baze komisioni për vlerësimin e tenderëve do të bëjë këtë vlerësim.

Mungesa e kriterëve të qarta dhe të matshme krijon mundësinë që vlerësimi të bëhet mbi baza subjektive dhe diskrecionale, duke i dhënë komisionit vlerësues kompetencë të pakufizuar për të vendosur mbi pranueshmërinë e ofertave, pa u mbështetur në kriteret të parapërcaktuara në dosjen e tenderit.

Një formulim i tillë bie ndesh me parimet e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë, pasi operatorët ekonomikë nuk janë në gjendje të kuptojnë paraprakisht se cilat marka apo prodhues konsiderohen të pranueshëm dhe mbi çfarë baze do të vlerësohet cilësia e produkteve të ofruara.

Për këtë arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që këtë pjesë të kriterit ta largojë nga Dosja e Tenderit e kështu garanton trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe konkurrencë të ndershme.

Pergjigje ne letren e AK-se rreth kerkeses per rishqyrtim:

Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, e ka cilësuar këtë pretendim si të pabazuar, duke arsyetuar se dorëzimi i katalogut nga operatori ekonomik është i domosdoshëm për të mundësuar vlerësimin e produkteve të ofertuara në raport me cilësinë dhe standardin e kërkuar sipas specifikimeve të Dosjes së Tenderit.

Megjithatë, ky arsyetim nuk i përgjigjet fare pretendimit tonë. Në kërkesën për rishqyrtim ne nuk kemi kërkuar në asnjë moment që të hiqet kërkesa për dorëzimin e katalogut, e as që kemi kontestuar domosdoshmërinë e tij. Përkundrazi, kërkesa jonë ka qenë e kufizuar vetëm në largimin e pjesës së formulimit ku Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar se: "Cilësia e pajisjeve duhet të jetë e lartë dhe të njohura nga kompanitë prodhuese të pranueshme për cilësi të prodhimit."

Konsiderojmë se kjo kërkesë është e paqartë, e papërcaktuar dhe lë hapësirë për interpretim subjektiv, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar asnjë kriter objektiv mbi bazën e të cilit Komisioni i Vlerësimit do të konstatojë nëse cilësia e pajisjeve është "e lartë" apo nëse prodhuesi konsiderohet "kompani e pranueshme për cilësi të prodhimit".

Autoriteti Kontraktues nuk ka sqaruar se cilat standarde, certifikime, kritere teknike apo parametra objektivë do të përdoren gjatë procesit të vlerësimit. Për pasojë, një formulim i tillë u jep anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit diskrecion të pakufizuar për të vlerësuar ofertat sipas bindjes së tyre subjektive, gjë që është në kundërshtim me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

Për më tepër, përgjigjja e Autoritetit Kontraktues jo vetëm që nuk e ka trajtuar pretendimin tonë, por ka krijuar edhe paqartësi shtesë lidhur me vetë kërkesën e Dosjes së Tenderit. Në përgjigjen e tij, Autoriteti Kontraktues shprehet se, citojmë: "...dorëzimi i katalogut nga operatori ekonomik është i domosdoshëm për të mundësuar vlerësimin e produkteve të ofertuara...".

Ky formulim bie në kundërshtim me përmbajtjen e Dosjes së Tenderit, ku kërkesa është formuluar në mënyrë që krijon përshtypjen se katalogu duhet të jetë i prodhuesit dhe se pranueshmëria lidhet me cilësinë e prodhuesit. Ndërsa në përgjigjen ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues e zhvendos fokusin duke deklaruar se katalogu dorëzohet nga operatori ekonomik. Kjo mospërputhje dëshmon se vetë Autoriteti Kontraktues nuk ka një qëndrim të qartë mbi mënyrën e zbatimit të kësaj kërkesë, duke krijuar konfuzion dhe pasiguri juridike për operatorët ekonomikë.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk e ka analizuar fare thelbin e pretendimit tonë, por i është përgjigjur një çështjeje që nuk ka qenë objekt i kërkesës për rishqyrtim. Ne nuk kemi kontestuar detyrimin për dorëzimin e katalogut, por kemi kërkuar që të hiqet formulimi i paqartë dhe subjektiv lidhur me "cilësinë e lartë" dhe "kompanitë prodhuese të pranueshme", pasi mungesa e kritereve objektive për vlerësimin e këtyre elementeve cenon transparencën e procedurës, krijon mundësi për interpretim arbitrar dhe bie ndesh me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik.

Konkluzion

Duke u bazuar në të gjitha faktet, argumentet dhe shkeljet e paraqitura në këtë ankesë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues, gjatë hartimit të Dosjes së Tenderit dhe kritereve të kualifikimit, ka vendosur kërkesa që janë të paqarta, joproporcionale dhe në kundërshtim me

dispozitat dhe parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik. Po ashtu, përgjigja e dhënë ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim nuk i ka trajtuar në mënyrë substanciale pretendimet tona, por është kufizuar në konstatime të përgjithshme, pa analizuar faktet dhe argumentet e paraqitura.

Për rrjedhojë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që:

- ta aprovojë ankesën tonë si të bazuar;
- ta anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim;
- ta obligojë Autoritetin Kontraktues që të bëjë korrigjimin e Dosjes së Tenderit, duke larguar ose riformuluar kërkesat dhe kriteret e kontestuar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, në mënyrë që ato të jenë të qarta, objektive, proporcionale dhe të mos kufizojnë konkurrencën;
- ta obligojë Autoritetin Kontraktues që, pas përmirësimit të Dosjes së Tenderit, të zgjasë afatin për dorëzimin e ofertave, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë mundësi të barabartë për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave në përputhje me ndryshimet e bëra.

Vendosja e kriterëve të qarta, objektive dhe proporcionale është kusht themelor për garantimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, transparencës së procedurës së prokurimit dhe zhvillimit të një konkurrence të ndershme, ashtu siç kërkohet nga Ligji për Prokurimin Publik.

Lidhur me pretendimet e OEN.P.T. "Haxhijaha" SH.P.K., ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0543 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me Njoftimin e Kontratës (B05), përkatësisht me kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit dhe Njoftimin e Kontratës, për të cilat Operatori Ekonomik ankues pretendon se janë kufizuese, diskriminuese dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), përkatësisht me:

- Neni 1 – Qëllimi;
- Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
- Neni 7 – Barazia në Trajtim dhe Mosdiskriminimi;
- Neni 27 – Dosja e Tenderit;
- Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale.

Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 290,000.00 €.

Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se Autoriteti Kontraktues më 23.06.2026 ka ngarkuar/publikuar B05 Njoftim për Kontratë.

Operatori Ekonomik ankues me datën: 15.07.2026, ka dorëzuar kërkesa për rishqyrtim te Autoriteti Kontraktues (AK) me pretendimit se kërkesat e përcaktuara në Njoftim për kontratë dhe në Fletën e të dhënave të tenderit FTD janë kufizuese dhe diskriminuese.

Autoriteti Kontraktues (AK) me Vendimin e datës 21.07.2026 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik ankues kundër njoftimit për kontratë, si të pabazuar.

Operatori Ekonomik ankues “N.P.T. HAXHIJAH SH.P.K.” pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim me datën: 27.07.2026, ka parashtruar ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), kundër njoftimit për kontratë, duke pretenduar se Autoriteti Kontraktues, gjatë hartimit të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit, ka vendosur kërkesa kufizuese dhe diskriminuese, të cilat kanë cenuar konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën me nr. 2026/0543 pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) janë të njëjta me pretendimet e parashtruara në kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues. Për këto pretendime, Autoriteti Kontraktues ka dhënë qëndrimin dhe arsyetimin e tij përmes vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Pas analizimit të pretendimeve të OE ankues, arsyetimit të Autoritetit Kontraktues të dhënë në Vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim kundër B05-Njoftim për Kontratë, si dhe pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit dhe të gjithë dokumentacionit të administruar për aktivitetin e prokurimit, ekspertja shqyrtuese ka trajtuar dhe analizuar secilin pretendim ankimor të ngritur nga Operatori Ekonomik ankues si ne vijim:

PRETENDIMI 1:

Pas shqyrtimit të dosjes së tenderit, konkretisht Fletës së të Dhënave të Tenderit, të kërkesat me numër 9.1 dhe 9.2, që kanë të bëjnë me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kemi konstatuar se kërkesa nr. 1 nuk është në përputhje me natyrën dhe objektin e kësaj kontrate.

Në kërkesën nr. 1 është përcaktuar, citojmë:

"OE duhet të ketë një agronom të diplomuar për dhënien e këshillave për fermerë për përdorimin e pajisjeve bujqësore."

Ndërsa si dëshmi është kërkuar:

"Të dorëzohet diploma e Fakultetit të Bujqësisë dhe kontrata e punës minimumi 1 (një) vit, sa zgjat periudha e monitorimit."

Vlerësojmë se kjo kërkesë nuk lidhet me objektin e prokurimit, pasi kjo procedurë është zhvilluar për furnizim me pajisje/mekanizëm bujqësor dhe jo për ofrim shërbimesh këshilluese.

Vetë formulimi i kriterit dhe dëshmisë kërkon që operatori ekonomik të ofrojë një shërbim këshillimor gjatë periudhës së monitorimit, gjë që nuk është pjesë e objektit të kontratës së furnizimit. Kjo nënkupton se autoriteti kontraktues po kërkon nga operatorët ekonomikë një shërbim profesional, ndërkohë që procedura është shpallur si kontratë furnizimi.

Për më tepër, kërkesa që agronomi të japë këshilla për përdorimin e pajisjeve bujqësore nuk përputhet me profilin profesional të agronomit. Kompetencat profesionale të një agronomi lidhen kryesisht me:

- këshillimin për mbjelljen dhe kultivimin e bimëve;
- analizën e tokës dhe rekomandimin e plehrave;
- identifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve;
- planifikimin e ujitjes dhe praktikave të kultivimit;

- monitorimin e zhvillimit të kulturave bujqësore;
- rekomandimin e metodave moderne të prodhimit bujqësor;
- këshillimin për përzgjedhjen e farave dhe varieteteve të përshtatshme.

Asnjë nga këto kompetenca nuk lidhet drejtpërdrejt me trajnimin ose këshillimin teknik për përdorimin dhe operimin e mekanizmit apo pajisjeve bujqësore, kompetencë e cila zakonisht i përket prodhuesit, distributorit ose personelit teknik të specializuar për pajisjet përkatëse.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se ky kriter është joproporcional, nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës dhe kufizon pa nevojë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke qenë në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe konkurrencës efektive në procedurat e prokurimit publik.

Për këto arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të rishqyrtojë këtë kriter dhe ta largojë atë nga dosja e tenderit, pasi nuk është i lidhur me natyrën dhe objektin e kësaj kontrate të furnizimit.

PËRGJIGJE E AUTORITETIT KONTRAKTUES NDAJ PRETENDIMIT NR.1 TË KËRKESËS PËR RISHQYRTIM

Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik (OE) ankues, e ka cilësuar këtë pretendim si të pabazuar, duke arsyetuar se kërkesat për stafin profesional janë të domosdoshme, për arsye se ekziston një periudhë e monitorimit të pajisjeve dhe përdorimit të tyre, gjatë së cilës, sipas këtij projekti, fermerët duhet të kenë një adresë ku të kërkojnë këshilla për përdorimin e pajisjeve bujqësore me të cilat furnizohen.

Pra, sipas Autoritetit Kontraktues, ekziston edhe një shërbim i këshillimit të domosdoshëm dhe pikërisht për të mbuluar këtë aspekt është vendosur kjo kërkesë në Dosjen e Tenderit (DT).

Prandaj, Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se pretendimi i parë i Operatorit Ekonomik ankues është i pabazuar.

VLERËSIMI I EKSPERTES SHQYRTUESE PËR PRETENDIMIN ANKIMOR NR.1

Pas shqyrtimit të pretendimit të Operatorit Ekonomik ankues, përgjigjes së Autoritetit Kontraktues, si dhe dokumentacionit të aktivitetit të prokurimit, përfshirë Dosjen e Tenderit, Fletën e të Dhënave të Tenderit dhe specifikimet teknike, ekspertja shqyrtuese vlerëson se objekti i kontratës nuk përfshin vetëm furnizimin me pajisje mekanike në mënyrë të përgjithshme, por furnizimin me pajisje të cilat përdoren drejtpërdrejt në proceset e prodhimit bujqësor.

Nga specifikimet teknike rezulton se do të furnizohen:

- Mikser për përgatitjen e ushqimit voluminoz
- Rimorkio për shpërndarjen e plehut organik shtazor
- Frezë 1.65m
- Rimorkio për shpërndarjen e plehut organik për pula
- Makin për shpërndarjen e plehut mineral (granular) – me kardan
- Spërkatëse për kultura bujqësore -lavërtare dhe perimore

Ekspertja vlerëson se për secilën nga këto pajisje ekziston dallim ndërmjet demonstrimit teknik të funksionimit të pajisjes dhe këshillimit profesional për përdorimin e saj në praktikën bujqësore.

- Për mikserin për përgatitjen e ushqimit voluminoz, personeli teknik mund të demonstrojë funksionimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes, ndërsa këshillimi lidhur me përgatitjen e racioneve ushqimore dhe përdorimin e tyre sipas nevojave të fermës kërkon njohuri profesionale nga fusha e bujqësisë.
- Për rimorkiot për shpërndarjen e plehut organik dhe makinën për shpërndarjen e plehut mineral, personeli teknik mund të shpjegojë mënyrën e funksionimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve. Ndërsa përcaktimi i sasisë së plehut, normave të aplikimit, kohës së përdorimit dhe përshtatjes sipas produkteve bujqësore janë çështje që lidhen me njohuritë profesionale agronomike.
- Për frezën 1.6 m, tekniku mund të demonstrojë përdorimin mekanik dhe mirëmbajtjen e pajisjes, ndërsa këshillimi lidhur me kohën e punimit të tokës, mënyrën dhe thellësinë e punimit të tokës, si dhe përshtatjen e këtyre parametrave sipas kulturave bujqësore, lidhet me njohuri profesionale agronomike.
- Për spërkatësen për kultura lavertare dhe perimore, tekniku mund të demonstrojë përdorimin mekanik të pajisjes, si presionin, kalibrimin dhe mirëmbajtjen, ndërsa përzgjedhja e mënyrës së aplikimit, dozave, kohës së spërkatjes dhe përdorimit të drejtë në kulturat bujqësore kërkon njohuri profesionale nga fusha e agronomisë.

Nga kjo analizë rezulton se, nëse kontrata do të kishte për objekt vetëm furnizimin, dorëzimin dhe demonstrimin teknik të pajisjeve, atëherë një person teknik i trajnuar nga prodhuesi ose distributori i pajisjeve do të mund të konsiderohej i mjaftueshëm për realizimin e këtyre detyrave.

Megjithatë, në rastin konkret, pajisjet objekt i kontratës lidhen drejtpërdrejt me procese bujqësore, si ushqimi i kafshëve, plehërimi organik dhe mineral, punimi i tokës dhe mbrojtja e kulturave bujqësore. Për këtë arsye, përdorimi i tyre nuk kufizohet vetëm në funksionimin mekanik të pajisjes, por kërkon edhe njohuri mbi mënyrën e përdorimit të drejtë dhe efektiv të tyre në praktikën bujqësore.

Për rrjedhojë, ekspertja vlerëson se kërkesa e Autoritetit Kontraktues për angazhimin e një agronomi paraqet lidhje të arsyeshme me objektin e kontratës dhe qëllimin e projektit, i cili synon jo vetëm furnizimin me mekanizëm bujqësor, por edhe sigurimin e përdorimit të drejtë nga fermerët përfitues.

Bazuar në analizën e mësipërme, ekspertja shqyrtuese vlerëson se pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues është i pabazuar.

PRETENDIMI 2:

- Në Dosjen e Tenderit, konkretisht në Fletën e të Dhënave të Tenderit, te kërkesat me numër 9.1 dhe 9.2, që kanë të bëjnë me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, në kërkesën nr. 2 është përcaktuar, citojmë:

"OE duhet që gjatë procesit të aplikimit ta dorëzojë katalogun me informata të mjaftueshme dhe dëshmi që pajisjet me të cilat është duke aplikuar ti kenë specifikat e kërkuara. Të gjitha

specifikat duhet të gjenden në katalogun e dorëzuar gjatë aplikimit, pasi të vlerësohen lidhur me cilësinë e pajisjeve që do ti ofrojnë. Cilësia e pajisjeve duhet të jetë e lartë dhe të njohura nga kompanitë prodhuese të pranueshme për cilësi të prodhimit."

Ndërsa si dëshmi është kërkuar:

"Kopja e katalogut me informata të mjaftueshme dhe dëshmi që pajisjet me të cilat është duke aplikuar ti kenë specifikat e kërkuara. Të gjitha specifikat duhet të gjenden në katalog."

Konsiderojmë se kjo kërkesë është e paqartë dhe lë hapësirë për interpretim subjektiv, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar asnjë kriter objektiv mbi bazën e të cilit do të vlerësohet nëse "cilësia e pajisjeve është e lartë" apo nëse prodhuesi është "kompani e pranueshme për cilësi të prodhimit".

Nga formulimi aktual nuk është e qartë se:

- cilat standarde, certifikime apo kritere do të përdoren për të vlerësuar cilësinë e pajisjeve;
- cilat kompani prodhuese konsiderohen "të pranueshme";
- mbi çfarë baze komisioni për vlerësimin e tenderëve do të bëjë këtë vlerësim.

Mungesa e kritereve të qarta dhe të matshme krijon mundësinë që vlerësimi të bëhet mbi baza subjektive dhe diskrecionale, duke i dhënë komisionit vlerësues kompetencë të pakufizuar për të vendosur mbi pranueshmërinë e ofertave, pa u mbështetur në kritere të parapërcaktuara në dosjen e tenderit.

Një formulim i tillë bie ndesh me parimet e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë, pasi operatorët ekonomikë nuk janë në gjendje të kuptojnë paraprakisht se cilat marka apo prodhues konsiderohen të pranueshëm dhe mbi çfarë baze do të vlerësohet cilësia e produkteve të ofruara.

Për këtë arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që këtë pjesë të kriterit ta largojë nga Dosja e Tenderit e kështu garanton trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe konkurrencë të ndershme.

PËRGJIGJE E AUTORITETIT KONTRAKTUES NDAJ PRETENDIMIT NR.2 TË KËRKESËS PËR RISHQYRTIM

Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik (OE) ankues, e ka cilësuar këtë pretendim si të pabazuar, duke arsyetuar se dorëzimi i katalogut nga operatori ekonomik është i domosdoshëm për të mundësuar vlerësimin e produkteve të ofertuara në raport me cilësinë dhe standardin e kërkuar sipas specifikave të DT,

VLERËSIMI I EKSPERTES SHQYRTUESE PËR PRETENDIMIN ANKIMOR NR.2

Nga analiza e Dosjes së Tenderit, rezulton se Autoriteti Kontraktues në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FTD), në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale sipas nenit 9.1 dhe 9.2, ka kërkuar që operatorët ekonomikë të dorëzojnë katalogun e pajisjeve të ofertuara, në të cilin duhet të jenë të paraqitura të gjitha specifikimet teknike të kërkuara. Për më tepër, në të njëjtën kërkesë është kërkuar që "Cilësia e pajisjeve duhet të jetë e lartë dhe të njohura nga kompanitë prodhuese të pranueshme për cilësi të prodhimit".

Ekspertja vlerëson se kërkesa për dorëzimin e katalogut është e arsyeshme dhe në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së pajisjeve të ofertuara me specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit. Përmes katalogut, Autoriteti Kontraktues mund të verifikojë karakteristikat teknike të produkteve të ofruara dhe përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në dosje.

Megjithatë, ekspertja konsideron se objekti i pretendimit të ankuesit nuk ka qenë kërkesa për dorëzimin e katalogut, por formulimi sipas të cilit pajisjet duhet të jenë "të cilësisë së lartë" dhe nga "kompani prodhuese të pranuar".

Nga analiza e Dosjes së Tenderit rezulton se Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar kritere objektive, standarde teknike, certifikime apo parametra të verifikueshëm mbi bazën e të cilëve do të vlerësohet nëse një pajisje konsiderohet "e cilësisë së lartë" apo nëse një prodhues konsiderohet "kompani prodhuese e pranuar". Po ashtu, nuk është përcaktuar metoda ose baza mbi të cilën Komisioni i Vlerësimit do të bëjë këtë vlerësim.

Ekspertja vlerëson se përdorimi i këtyre formulimeve, pa kritere të qarta dhe të matshme, mund të krijojë hapësirë për interpretim subjektiv gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, duke mos u mundësuar operatorëve ekonomikë të kuptojnë paraprakisht se mbi çfarë baze do të vlerësohen ofertat e tyre. Rrjedhimisht, kjo kërkesë nuk është në përputhje me nenin 28 të LPP-së dhe nenin 19.4 të Rregullores për Prokurim Publik, pasi specifikimet dhe kërkesat teknike duhet të jenë të përcaktuara në mënyrë të qartë, objektive, të sakta dhe të zbatueshme në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, duke garantuar transparencë, trajtim të barabartë dhe konkurrencë të drejtë në procedurën e prokurimit.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përcaktojë kërkesa që sigurojnë cilësinë dhe përshtatshmërinë e produkteve të furnizuara, por këto kërkesa duhet të jenë të qarta dhe të paracaktuara në mënyrë që operatorët ekonomikë të kenë mundësi të kuptojnë paraprakisht kriteret që duhet ti përmbushin dhe mënyrën se si do të vlerësohen ofertat e tyre.

Gjithashtu, ekspertja konstaton se Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim, është fokusuar vetëm në arsyetimin e domosdoshmërisë së dorëzimit të katalogut për verifikimin e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofruara. Megjithatë, AK nuk ka dhënë sqarime lidhur me thelbin e pretendimit të Operatorit Ekonomik ankues, i cili kishte të bënte ekskluzivisht me formulimet "cilësi e lartë" dhe "kompani prodhuese të pranueshme", përkatësisht nuk ka përcaktuar kriteret, standardet apo parametrat objektivë mbi bazën e të cilëve do të bëhej vlerësimi i këtyre kërkesave.

Për rrjedhojë, ekspertja vlerëson se përgjigjja e Autoritetit Kontraktues nuk adreson në mënyrë substanciale pretendimin e ngritur nga ankuesi dhe nuk ofron arsyetim të mjaftueshëm lidhur me domosdoshmërinë dhe mënyrën e vlerësimit të këtyre kërkesave.

Bazuar në analizën e mësipërme, ekspertja shqyrtuese vlerëson se kërkesa për dorëzimin e katalogut është e arsyeshme dhe e lidhur me objektin e kontratës, ndërsa formulimi i kërkesave lidhur me "cilësinë e lartë" të pajisjeve dhe "kompanitë prodhuese të pranueshme" nuk është i përcaktuar me kritere objektive dhe të verifikueshme. Për rrjedhojë, pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues është pjesërisht i bazuar.

Rrjedhimisht Autoriteti Kontraktues duhet të rishikojë dhe riformulojë këtë pjesë të kërkesës në Dosjen e Tenderit, duke përcaktuar standarde, kritere të qarta, objektive dhe të verifikueshme, të

cilat do tu mundësojnë operatorëve ekonomikë të kuptojnë paraprakisht kërkesat që duhet ti përmbushin dhe do të sigurojnë një vlerësim të barabartë dhe transparent të ofertave.

KONSTATIMI PËRFUNDIMTAR I EKSPERTES SHQYRTUESE

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, arsyetimit të Autoritetit Kontraktues të dhënë në Vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim kundër B05-Njoftim për Kontratë, si dhe pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit, Njoftimit për kontratë dhe të gjithë dokumentacionit të administruar për këtë aktivitet të prokurimit, Ekspertja Shqyrtuese konstaton se pretendimet e Operatorit Ekonomik e ankuesit janë pjesërisht të bazuara.

Lidhur me pretendimin e parë, që ka të bëjë me kërkesën për angazhimin e një agronomi, ekspertja shqyrtuese vlerëson se kjo kërkesë është në lidhje të drejtpërdrejtë me natyrën dhe qëllimin e kontratës dhe nuk rezulton të jetë kërkesë joproporcionale në raport me objektin e prokurimit.

Duke pasur parasysh se pajisjet objekt i furnizimit do të përdoren drejtpërdrejt në proceset që lidhen me ushqimin e bagëtive, plehërimit dhe mbrojtjes së kulturave bujqësore, përveç demonstrimit teknik të funksionimit të pajisjeve, nevojiten edhe njohuri profesionale për përdorimin dhe aplikimin e tyre në praktikën bujqësore. Për rrjedhojë, pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues vlerësohet si i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë, ekspertja shqyrtuese konstaton se kërkesa për dorëzimin e katalogut është e arsyeshme dhe e nevojshme për verifikimin e përputhshmërisë së pajisjeve me specifikimet teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Megjithatë, formulimi sipas të cilit pajisjet duhet të jenë "të cilësisë së lartë" dhe nga "kompani prodhuese të pranuar" nuk është shoqëruar me kritere objektive, standarde apo parametra të verifikueshëm mbi bazën e të cilëve do të realizohet vlerësimi.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim, nuk ka trajtuar thelbin e këtij pretendimi, por është ndalur vetëm në arsyetimin e domosdoshmërisë së dorëzimit të katalogut.

Për rrjedhojë, duke qenë se kërkesa për katalogun vlerësohet e ligjshme dhe proporcionale, ndërsa formulimet lidhur me "cilësinë e lartë" dhe "kompanitë prodhuese të pranuar" nuk janë të përcaktuara me kritere objektive dhe të verifikueshme, ky pretendim vlerësohet pjesërisht i bazuar.

Bazuar në analizën e mësipërme Ekspertja shqyrtuese vlerëson se Autoritetin Kontraktues duhet të bëjë korrigjimin e Dosjes së Tenderit, përkatësisht të riformulojë kërkesën e përcaktuar në Fletën e të dhënave të tenderit FTD neni 9.1 dhe 9.2 lidhur me formulimin se pajisjet duhet të jenë "të cilësisë së lartë" dhe nga "kompani prodhuese të pranuar", duke përcaktuar kritere të qarta objektive dhe të verifikueshme mbi bazën e të cilave do të bëhet vlerësimi i këtyre elementeve. Me rastin e riformulimit, Autoriteti Kontraktues duhet të ruajë qëllimin teknik dhe funksional të kërkesës, duke shmangur njëkohësisht formulimet e paqarta që mund të krijojnë kufizime të panevojshme të konkurrencës dhe të cenojnë parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim I fermëve me mekanizëm bujqësor” me numër të prokurimit:616-26-4982-1-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues të cilat i mbështet në tërësi, pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik N.P.T. “Haxhijaha” SH.P.K., aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim I fermëve me mekanizëm bujqësor” me numër të prokurimit:616-26-4982-1-1-1 qe AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III dhe IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - N.P.T. HAXHIJAH SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: